

**5 SHTATOR,
2014**

Më 5 shtator 2014, NATO samiti porositi nga Kardifi:

Inkurajojmë dhe përkrahim përpjekjet për vazhdim të reformave në vend, veçanërisht sa i përket sigurimit të **dialogut efektiv demokratik, lirisë së medie, pavarësisë së gjyqeve dhe shoqërisë funksionale multietnike** bazuar në implementimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

**15 SHTATOR,
2014**

Më 15 shtator 2014, Komisioni për vëzhgim të Kuvendit parlamentar të Këshillit të Evropës:

Procesi i lustrimit në Maqedoni është kontrovers, i diskutueshëm dhe i politizuar. Ligji për lustrim u hodh poshtë nga Gjykata kushtetuese dhe u hap rasti kundër procesit të lustrimit para Gjykatës evropiane për të drejta të njeriut nga ana e kryetarit të mëparshëm të Gjykatës kushtetuese. **Politizimi i tepruar i jetës publike,** sipas linjës partiake dhe përkatësisë etnike shkakton shqetësime serioze. Marrëdhëniet mes shumicës në pushtet dhe opozitës vazhdojnë të jenë të keqësuar dhe pengojnë procesin e vendimmarrjes. Politizimi dhe polarizimi gjithashtu dëmton besueshmërinë e publikut në gjyqësorin për shkak të perceptimit të pranishëm në pjesë të madhe të publikut për **drejtësi selektive.** Situata keqësohet me nivelin e lartë të korrupsionit në vend, përfshirë edhe **korupsionin e gjyqësorit.** Situata me mediet gjithashtu mbetet një çështje brenguese. Vazhdimisht deklarohet se ka shtypje mbi gazetarët, kurse disa palë të prekura mendojnë se legjislative për mediet, që janë në përgatitje paraqesin edhe një përpjekje për kufizim të lirisë së medie.

**30 SHTATOR,
2014**

Me 30 shtator të vitit 2014, Johanes Han, komisar i ri i KE për zgjerim, porositi para Parlamentit Evropian:

Shoh tre çështje „vendimtare“ për procesin e mëtutjeshëm të negociatave për zgjerim: **sundimi i së drejtës dhe të drejtat fundamentale,** ekonomia dhe funksionimi përkatës i demokracisë.

.....

Nuk duhet pasur përjashtime nga parimet kur bëhet fjalë për ballafaqimin me krimin e organizuar dhe korrupsionin, reformat në administratën publike, gjyqësori i pavarur dhe profesional. E njëjta vlen për të drejtat fundamentale: **nuk ka vend për diskriminim në shoqëritë që dëshirojnë ti bashkëngjiten BE-së.**

**2 TETOR,
2014**

Më 2 tetor të vitit 2014, Viktorija Njulend porositi nga Uashingtoni:

Si mundeni natën të flini nën çatinë e anëtarit 5 të NATO-së, kurse ditën të nxisni „**demokraci jo-liberale**“, të promovoni nacionalizëm, të kufizoni mediet e lira ose të demonizoni shoqërinë civile?

**6 TETOR,
2014**

Më 6 tetor të vitit 2014, Federata ndërkombëtare e gazetarëve dhe Federata evropiane e gazetarëve kërkuan:

1. Ndryshim të legjislaturës së vendit në drejtim të pajtimit me normat ndërkombëtare për lirinë e shprehjes dhe aplikimi i barabartë të këtij ligji pa diskriminim. 2. **Ndalimin e të gjitha presioneve dhe kufizimeve të papërshtatshme ndaj medie dhe pavarura dhe atyre me mendim kritik; rishqyrtimi i të gjitha veprimeve të ndërmarra ndaj gazetarëve dhe ofrim i kompensimit për viktimat e masave të papërshtatshme dhe padrejta. Kjo ka të bëjë me mbylljen e disa shtëpive mediatike dhe vendimin e gjyqit kundër Tomisllav Kezharovski.** 3. Sigurimin e paanshmërisë së gjyqeve dhe revizionin e procedurave gjyqësore për shkak të marrjes së vendimeve gjyqësore në pajtim me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. 4. Trajnimin e gjykatësve për zbatim përkatës të Ligjit për shpifje dhe ofendim në

pajtim me standardet dhe praktikat ndërkombëtare; **garanci që funksionarët shtetëror dhe partiak do të përmbahen nga paditë kundër gazetarëve hulumtues dhe mediet** për shkak të zbulimit ligjësor të informatave me karakter publik. 5. **Sigurimin e transparencës së plotë të kampanjave mediatike të qeverisë me interes të qartë publik të bazuar në kritere objektive;** Qeveria është një prej financiarëve kryesor në mediet private. 6. Qeveria duhet të mbron paanshmërinë e organit rregullues për mediet dhe të mbron nga ndikimet partiake dhe ekonomike. 7. Liria e garantuar për bashkim të gazetarëve; hetim të detajuar mbi përfshirjen e Qeverisë në punën e sindikatave dhe shoqatave të gazetarëve. 8. **Përpjekje maksimale për hetim të të gjitha rasteve të dhunës mbi gazetarë dhe kërkim i përgjegjësisë nga autorët e krimeve për ti dhënë fund mos-dënimit.**

.....

12. Ndalim i të gjitha përpjekjeve për marginalizim dhe diskreditim të punës dhe rolit të sindikatave të pavarura dhe shoqatave profesioniste të themeluara me qëllim që të mbrojnë të drejtat e gazetarëve, si dhe pavarësia dhe standardet në profesionet. **Liria e bashkimit duhet të jetë absolutisht e garantuar dhe e mbrojtur.** 13. Hapërimi në profesionin e gazetarisë dhe e drejta për të qenë gazetar nuk duhet rregulluar me çfarëdo definicioni ose rregullore ligjore.

**8 TETOR,
2014**

Me 8 tetor të vitit 2014 Federata evropiane e gazetarëve porositi:

Jemi thellësisht të dëshpëruar që **qeveria juaj vazhdon të injoron parimet themelore dhe vlerat ndërkombëtare të gazetarisë së pavarur** dhe nuk bën asgjë që të mbron lirinë, gazetarët hulumtues dhe lirinë e të shprehurit.

